Në bazë të nenit 2, al. 4, dhe nenit 9, al. 1 dhe 2 të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, , nenit 12, al. 1 dhe 2, pika c, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 27, al. 1 dhe 5 të Statutit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e mbajtur më 8 mars 2012, miratoi

# RR E G U LL O R E N PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

## **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

Qëllimi

## Neni 1

Kjo Rregullore do të sigurojë përdorimin e gjuhëve zyrtare në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, në punën e administratës komunale, në institucionet arsimore dhe shëndetësore që themelohen, apo qeverisen nga Komuna dhe në ndërmarrjet publike lokale të themeluara nga Komuna.

## Neni 2

Në territorin e Komunës së Prizrenit - gjuhë zyrtare dhe në përdorim të barabartë në të gjitha organet e administratës komunale, institucionet arsimore dhe shëndetësore, si dhe në ndërmarrjet publike lokale të Komunës së Prizrenit janë: gjuha shqipe, serbe, turke dhe boshnjake.

# PËRDORIMI I GJUHËVE

I. Përdorimi i gjuhëve në takime zyrtare, në tubime publike, mbledhjet e Kuvendit të Komunës dhe në punën e organeve të administratës

## Neni 3

Gjuhët e përcaktuara në nenin 2 të kësaj Rregulloreje si gjuhë zyrtare - do të përdoren në baza të barabarta në takimet me qytetarë, në mbledhjet e Kuvendit të Komunës, në punën e organeve të administratës, në kolegjiumin e drejtorëve, në komitetet e përhershme dhe në komitetet

(komisionet) e tjera të themeluara nga Kuvendi, si dhe gjatë komunikimit me qytetarët.

Materialet për mbledhje, për anëtarët e Kuvendit dhe të komitetevekomisioneve, apo të trupave të tjera që themelohen nga Kuvendi, do të përgatiten dhe dërgohen në gjuhën për të cilën deklarohen vetë anëtarët.

Sipas nevojës, Sektori për Përkthime pranë Drejtorisë së Administratës, do të mundësojë përkthimin simultan nga një gjuhë zyrtare në tjetrën, që janë në përdorim zyrtar, nëse kjo kërkohet për takimet zyrtare, si: takimet publike, mbledhjet e Kuvendit, takimet e komiteteve-komisioneve dhe takimet e tjera të organizuara nga Komuna.

#### Neni 4

Procesverbalet nga takimet, kolegjiumet dhe mbledhjet, mbahen në gjuhën shqipe, por ato do të përkthehen edhe në gjuhët e tjera zyrtare që janë në përdorim zyrtar.

Veb faqja e Komunës do të jetë në gjuhët që janë në përdorim zyrtarë në territorin e Komunës.

#### Neni 5

Statuti i Komunës, Rregullorja e Punës e Kuvendit, rregulloret komunale dhe vendimet që miratohen nga Kuvendi i Komunës, publikohen në gjuhët: shqipe, serbe, turke dhe boshnjake.

# II. Përdorimi i gjuhëve nga individët, institucionet, shoqëritë tregtare dhe organizatat

#### Neni 6

Gjatë komunikimit me organet e institucioneve të cekura në nenin 1, 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje, palët mund të drejtohen me shkrim apo gojarisht dhe të marrin përgjigje në cilëndo gjuhë që është në përdorim zyrtar në territorin e Komunës së Prizrenit.

Gjuha e palës do të konsiderohet gjuha sipas së cilës pala fillimisht i është drejtuar Komunës (organeve, institucioneve dhe ndërmarrjeve lokale që themelohen apo qeverisen nga Komuna).

#### Neni 7

Komunikimi me komunat e tjera të Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës, shoqëritë tregtare, organet dhe organizatat e tjera, do të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

## III. Përdorimi i gjuhëve në emërtimet dhe shenjat zyrtare

## Neni 8

Emërtimet e organeve komunale, të institucioneve arsimore dhe shëndetësore, ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prizrenit, mbishkrimet publike dhe lajmërimet, jepen paralelisht në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në territorin e komunës.

#### Neni 9

Shenjat zyrtare që tregojnë emrat e vendbanimeve, të lagjeve, të rrugëve dhe të vendeve të tjera publike, duhet të jenë të shkruara autentikisht në gjuhët zyrtare që janë në përdorim në territorin e komunës

## Neni 10

Shkresat publike dhe njoftimet e organeve të Komunës duhet të përgatiten në të gjitha gjuhët zyrtare në komunës.

#### Neni 11

Të gjitha dokumentet dhe shkresat të cilat lëshohen nga ana e organeve komunale duhet të lëshohen në gjuhët zyrtare të komunës.

## DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

## Neni 12

Palët e pakënaqur nga zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Prizrenit kanë të drejtë të ushtrojnë ankesa-parashtresa pran organeve gjegjëse.

## Neni 13

Në rast nevoje, kjo Rregullore mund të ndryshohet me procedurë të njëjtë me atë të miratimit.

## Neni 14

Në rast të mospajtimeve ndërmjet dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

## Neni 15

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje do të kujdesen: kryetari i Komunës dhe drejtorët e drejtorive komunale.

Kjo Rregullore hyn në fuqi që nga dita e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRIZRENIT Kuvendi i Komunës Nr. 01/011-3250 Data: 8 mars 2012 Prizren

> Kryesuesi i Kuvendit të Komunës Nijazi Kryeziu

This document was cr The unregistered vers	reated with Win2PDF a ion of Win2PDF is for e	vailable at http://www.daevaluation or non-comm	aneprairie.com. nercial use only.